



СТОМАТОЛОШКА КОМОРА НА МАКЕДОНИЈА
ODA STOMATOLOGJIKE E MAQEDONISË
MACEDONIAN DENTAL CHAMBER

Në bazë të nenit 22, paragrafi 2 të Rregullores për zgjedhjen dhe shkarkimin e anëtarëve të Këshillave Rajonalë, delegatëve të Kuvendit dhe kryetarit të Odës Stomatologjike të Maqedonisë nr. 02-32/6, datë 25.03.2022, Komisioni Qendror i Zgjedhjeve i Odës Stomatologjike të Maqedonisë publikon këtë

N J O F T I M

Votimi për zgjedhjen e anëtarëve të Këshillave Rajonalë dhe delegatëve në Kuvendin e Odës Stomatologjike të Maqedonisë për Këshillat Rajonalë të Shtipit, Velesit, Kumanovës, Sveti Nikoles dhe Gjevgjeli do të zhvillohet më 22.09.2026, nga ora 10:00 deri në orën 15:00, në vendvotimet e përcaktuara nga KQZ-ja, me propozim të komisioneve përkatëse rajonale të zgjedhjeve, si vijon:

- Këshilli Rajonal Veles – në hapësirat e ISHP Spitali i Përgjithshëm – Veles, (salla e mbledhjeve), Veles;
- Këshilli Rajonal Gjevgjeli – në kafebarin Bellissimo Coffee House, në rr. Risto Farshinin nr. 20, Gjevgjeli;
- Këshilli Rajonal Kumanovë – në Muzeun e Kumanovës, në rr. Done Bozhinov nr. 24, Kumanovë;
- Këshilli Rajonal Shtip – në hapësirat e ISHP Qendra Shëndetësore „Dr. Pançe Karagjozov“ Shtip, kati i 5-të, salla e mbledhjeve;
- Këshilli Rajonal Sveti Nikole – në hapësirat e Qendrës Shëndetësore Sv. Nikole.

Votimi kryhet personalisht dhe drejtpërdrejt, me dokument të vlefshëm për identifikim personal (letërnjoftim ose pasaportë) dhe me paraqitjen e barkodit unik nga aplikacioni mobil i Odës. Votuesit, me votim të fshehtë, zgjedhin kandidatët.

Ky njoftim do të publikohet në ueb-faqen e Odës dhe në dy gazetatat ditore (në gjuhën maqedonase dhe shqipe) që shpërndahen në territorin e gjithë shtetit.

Shkup, 18.09.2026

ODA STOMATOLOGJIKE E MAQEDONISË
Komisioni Qendror i Zgjedhjeve
Kryetar,
Dr. Aleksandar Stojanovski

